



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
F I E R

Nr. 117 Prot.

Fier, më 07.06.2024

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 46, datë 07.06.2024

**PËR
REKOMANDIMET PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2024, NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS
SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER**

Në mbështetje të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 41 pika 1, nenit 42 gërmat "a" "g", "h", nenit 43, nenit 45 dhe nenit 46 pikat 1 e 2 gërma "c" e pika 4 të ligjit nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 05, datë 16.05.2024 "*Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm*", Rregulloren Standarte të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Ky udhëzim ka për qëllim unifikimin e ndjekjes penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe zbatimin e

rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 243, datë 17.04.2024, si dhe Udhëzimin e Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 05, datë 16.05.2024 “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”, duke respektuar pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit.

Neni 2 Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi janë:
 - a) Përcaktimi i masave administrative për realizimin e përparësive që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare në kompetencë të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
 - b) Përcaktimi i masave procedurale lidhur me mënyrën e vlerësimit, ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve prioritare, të cilat rritin efikasitetin në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, sipas prioriteteve të rekomanduara dhe kompetencës në ushtrimin e funksioneve nga prokurorët.
 - c) Përcaktimi i mënyrës dhe formave të komunikimit ndërmjet oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, për zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe udhëzimeve të nxjerra në zbatim të tyre.

Neni 3 Përkufizime

1. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “*Rekomandime prioritare*” janë rekomandimet prioritare të miratuara nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, që i janë përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm nga Ministri i Drejtësisë, si dhe drejtuesve të Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm nga Prokurori i Përgjithshëm në takimin e datën 03.05.2024¹.
2. “*Drejtime të rekomanduara*” janë drejtimet kryesore të rekomandimeve prioritare për vitin 2024, përsa vijon: - *garantimi i pavarësisë së prokurorit*; - *lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar*; - *garantimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut*; - *nxitja e bashkëpunimit ndërinstytucional brenda e jashtë territorit të qarkut Fier dhe jo vetëm*.
3. “*Vepra penale prioritare të rekomanduara*” janë veprat penale dhe/ose grupvepra penale të përfshira në drejtimet përkatëse të rekomanduara dhe/ose ato të cituara në rekomandimet prioritare dhe/ose në këtë udhëzim, përsa vijon, *veprat penale kundër korrupsionit, veprat penale në fushën e narkotikëve, krimet e rënda, trafiket, terrorizmi dhe veprat penale që çënojnë sigurinë kombëtare, pastrimi i parave, krimi kibernetik, veprat penale kundër mjedisit, krimi në familje dhe dhuna ndaj grave, veprat me natyrë gjinore, seksuale, diskriminuese, keqtrajtimit, shfrytëzimit e trafikimit të të miturve, vepra penale në*

¹ Prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, drejtuesve të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe oficerëve të policisë gjyqësore u janë komunikuar/përcjellë nga drejtuesi i Prokurorisë Fier në mbledhjet e organizuara/zhvilluara në datat 09, 10 e 15 Maj 2024.

KREU II MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 4

Masat administrative në Prokurorinë Fier

1. Drejtuesit e seksioneve në Prokurorinë Fier brenda 10 ditëve nga administrimi i këtij udhëzimi, si dhe Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 05, datë 16.05.2024 *“Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”*, si dhe planit të veprimit të miratuar me Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 53, datë 16.05.2024, pas diskutimit dhe mendimit të marrë në mbledhjen e prokurorëve të Prokurorisë Fier që do organizohet nga drejtuesi, hartojnë/përgatitin planin e veprimit për vlerësimin dhe ndjekjen e masave dhe/ose aktiviteteve në afatet e përcaktuara, për zbatimin e rekomandimeve prioritare në seksionet dhe strukturat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

1.1. Në planin e veprimit parashikohen masat e nevojshme në përputhje me specifikat dhe gjendjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, përfshirë nevojat për buxhet (nëse është i nevojshëm), për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare.

1.2. Plani i veprimit, krahas masave dhe aktiviteteve konkrete, përmban edhe tregues statistikorë/indikatorë që do plotësohen për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve prioritare, udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerre në vijim, dhe udhëzimeve të përgjithshme të drejtuesit të prokurorisë.

2. Drejtuesit e seksioneve vlerësojnë dhe i propozojnë drejtuesit të prokurorisë marrjen e masave konkretë të nevojshme organizative në drejtim të riorganizimit të brendshëm, për koordinimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale e profesionale, dhe ndjekin/mbikëqyrin në vazhdimësi të ecurisë së zbatimit të tyre.

3. Drejtuesit e seksioneve dhe personat përgjegjës në Prokurorinë Fier, duhet të sigurojnë:

- marrjen e masave koordinuese dhe të duhura për funksionimin e plotë të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurorinë Fier, mbikëqyen teknike dhe administrative nëpërmjet kërkesave për informacion lidhur me mënyren e disponimit për hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrollin e mbikqyrjen e vazhdueshem mbi saktësinë e hedhjes dhe administrimit të këtyre të dhënave, duke njoftuar/raportuar drejtuesit të Prokurorisë çdo problematikë të konstatuar, si dhe propozuar masa përkatëse për përmirësimin apo rishikimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve, problematikë që më pas do paraqiten pranë strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

- vijimin e bashkëpunimit me agjencitë lokale, rajonale kufitare dhe qëndrore të zbatimit të ligjit, si dhe, përmes strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme, forcimin dhe

rritjen e bashkëpunimit me agjensi ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht që lidhen me korrupsionin, trafikimin e narkotikeve, pastrimin e parave, trafikimin e qenieve njerezore, veprat penale kundër mjedisit, krimet kibernetike, etj;

- marrjen e masave të nevojshme për funksionimin, hedhjen në mënyrë të saktë dhe përditësimin e të dhënave në sistemin e-tracking "PRESTO" për të gjitha fazat e procedimit penal, si për vënien në eficence sa më të plote, ashtu dhe për përfundimin e të dhënave statistikore, sipas një baze të dhënash të qëndrueshme e të besueshme;

- përmirësimin e koordinimit institucional dhe ndërinstitutional me institucionet dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, në lidhje me raportimet në zbatim të rekomandimeve;

- marrjen e masave për rritjen e mëtejshme të efikasitetit në bashkëpunimin ndërinstitutional për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval-it dhe zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 10/2020 "*Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave e krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*", i ndryshuar;

- monitorimin/kontrollin e të dhënave në sistemin elektronik "SVOPGJP" për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori, për numrin e veprimeve hetimore që kryejnë për secilin procedim penale apo procedim/hetim pasuror, si dhe kontrollin e respektimit të afateve dhe urdhërave të ligjshme të prokurorëve nga gjithë oficerët e policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve, me synim mbikëqyjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore për rritjen e efektivitetit dhe shpejtësisë së hetimeve. Për këtë qëllim, drejtuesit e seksioneve duhet: - të administrojnë të dhëna periodike përmes kërkesës së drejtuar drejtuesit të prokurorisë apo oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët i gjenerojnë nga sistemi dhe vënë në dispozicion të tyre; - të kërkojnë dhe marrin të dhëna nga zyra e regjistratit dhe protokollit që administrojnë lëvizjen e brendshme të materialeve të deleguara/dhënë për veprime dhe përfunduar sipas rregullores së brendshme të organizimit të prokurorisë dhe urdhërit të drejtuesit; - të bashkëpunojnë me prokurorët e çështjeve dhe mbajnë akt konstatimi për verifikimin e punës, respektimin e afateve dhe cilësisë së akteve të oficerëve të policisë gjyqësore, etj

- marrjen e të gjitha masave të nevojshme nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe personat e ngarkuar për administrimin në mënyrën dhe brenda afateve të caktuara, si dhe raportimin e të dhënave statistikore, etj, për drejtuesin e prokurorisë dhe për Prokurorinë e Përgjithshme.

4. Në kuadër të detyrimit të drejtuesit të prokurorisë për informimin e Prokurorit të Përgjithshëm në mënyrë periodike dhe sa herë kërkohet, ngarkohet drejtuesi i seksionit të posaçëm si person përgjegjës që të përgatitë në mënyrë periodike çdo tre muaj, dhe sa herë kërkohet, informacion për drejtuesin e prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm, për ecurinë e masave administrative e procedurale, angazhimet dhe progresin e arritur në zbatim të secilit prioritet të rekomanduar, shoqëruar me tregues/indikator statistikorë të saktë e analitikë dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, arritjet dhe problematikën, dhe si ka ndikuar zbatimi i tyre mbi gjendjen e kriminalitetit në prioritetet e rekomanduara.

5. Në kuadër të raportin vjetor të punës së Prokurorisë Fier, drejtuesi i seksionit të posaçëm të prokurorisë, gjithashtu, ngarkohet si personi përgjegjës që të analizojë në mënyrë

të detajuar zbatimin e rekomandimeve prioritare, lidhur me arritjet, problematikat dhe si ka ndikuar zbatimi i tyre mbi gjendjen e kriminalitetit në fushat/drejtimit e rekomanduara.

6. Ky udhëzimi i përgjithshëm dhe plani i veprimit që do dalë për zbatimin e rekomandimeve prioritare u njoftohet pa vonesë, të gjithë prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve të agjencive të tjera, duke përfshirë shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Komisarariatit të Policisë Lushnjë, Komisarariatit të Policisë Fier, Komisarariatit të Policisë Divjakë, Komisarariatit të Policisë Mallakastër, Agjencisë së Mbikqyrjes Policore Fier – Berat, Drejtorisë së Hetimit Doganor, Drejtorisë së Hetimit Tatimor, Inspektoriatit Rajonal të Mbrojtjes së Territorit, Agjencisë së Mbikqyrjes pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, etj. Një kopje e këtij udhëzimi të dërgohet në Prokurorinë e Përgjithshme.

KREU III

MASAT PROCEDURIALE PENALE

Neni 5

Masat procedurale të drejtuesit të prokurorisë

1. Drejtuesi i prokurorisë, me ndihmën e drejtuesve të seksioneve, vlerëson rekomandimet prioritare dhe nevojat për marrjen e masave procedurale në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale në përshtatje me gjendjen e treguesve të kriminalitetit dhe problematikat e evidentuara në Prokurorinë Fier, dhe për të lehtësuar e siguruar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me masat procedurale, duke respektuar pavarësinë e institucionit dhe garantuar pavarësinë e prokuroreve, merr masat si me poshtë:

a) miraton planin e veprimit për përmbushjen e rekomandimeve prioritare në luftë ndaj kriminalitetit për vitin 2024, si dhe një plan veprimi për ndjekjen e rekomandimeve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

b) ndjek me përparësi dhe vlerëson në dinamikë marrjen e masave të nevojshme për të përmbushur zbatimin e politikës penale kundër krimit, sipas drejtimeve dhe për veprat penale prioritare të rekomanduara, në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimin e Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 5/2024, duke treguar dilijencë në ushtrimin efektiv të ndjekjes penale dhe kujdesur për të garantuar respektimin e pavarësisë funksionale të prokurorëve nga çdo ndikim i paligjshëm i jashtëm apo i brendshëm në vendimarrjen e tyre, përmesa masave përkatëse të parashikuara në ligj dhe akte nënligjore;

c) nxjerr udhëzime të përgjithshme kur vlerëson apo mbi bazën e propozimit/rekomandimit të drejtuesve të seksioneve, që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe garantojnë e lehtësojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;

d) nxjerr udhëzime jo të detyrueshme për çështje/kallëzime konkrete, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje, përfshirë rastet e regjistruara/filluara kryesisht, ose kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së çështjes, në drejtimet prioritare të rekomanduara;

- e) koordinon veprimtarinë me prokuroritë e tjera dhe jo vetëm, për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimitet prioritare të rekomanduara;
- f) kërkon informacion dhe verifikon ecurinë/përfundimin e procedimeve në hetimet paraprake ose në gjykim, në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies, duke monitoruar sipas ligjit në veçanti, respektimin e afateve procedurale, rritjen e efektivitetit dhe plotëshmerisë së hetimeve, si dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor, përfshi shmangien e konfliktit të interesave apo shkaqeve të tjera të njëanshmërisë, për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence apo ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve në drejtimitet prioritare të rekomanduara;
- g) siguron përditësimin me të dhëna të sistemeve elektronike (PRESTO, SVHOPGJP dhe e-tracking) dhe regjistruar procedurale dhe administrative, si dhe mbikëqyr/kontrollon përmes personave të ngarkuar me urdhëra të veçantë (prokurorë ose drejtues seksioni) në vazhdimësi mbi saktësinë e të dhënave të regjistruara, administruara, dhe dërgimin në afat të të dhënave statistikore në Prokurorinë e Përgjithshme, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore;
- h) drejton, organizon dhe mbikëqyr, me anë të drejtuesve të seksioneve, shpërndarjen e çështjeve/kallëzimeve prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, duke garantuar shpërndarjen e barabratë, zbatimin e kriterëve të përcaktuara në ligj dhe udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3/2016, për të siguruar po ashtu paanshmërinë dhe vijueshmërinë e hetimeve në rastet e zëvendësimit të prokurorëve;
- i) nxit oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët të jenë më aktiv në marrjen e dëgjimit për vepra penale nga burime të hapura, dhe jo vetëm, për fillimin kryesisht të procedimeve/hetimeve duke përfshirë rastet e ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm në veprimtarinë e prokurorit, përmes raportimit të këtyre treguesve çdo 1 (një) muaj për drejtuesin e prokurorisë;
- j) mbi bazën e nevojave apo dhe sugjerimeve të drejtuesve të seksioneve apo prokurorëve, zhvillon mbledhje tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve dhe me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve apo të strukturave hetimore në shërbimet e Policisë Gjyqësore, në kuadër të luftës kundër veprave penale prioritare të rekomanduara;
- k) tregon vëmendje dhe nxjerr urdhëra për policinë gjyqësore që ka në juridiksion lidhur me ushtrimin e funksioneve në kuadër të luftës kundër veprave penale prioritare të rekomanduara dhe ato të lidhura me to;
- l) mbështet punën e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve nëpërmjet vlerësimit në kohë të kërkesave të tyre, për menaxhimin e duhur të burimeve njerëzore dhe logjistike në dispozicion, si dhe për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, për të siguruar aksesin për persona me paaftesi fizike dhe pritjen e publikut, sipas prioriteteve të rekomanduara;
- m) tregon vëmendje për evidentimin e vlerësimin e rasteve të hetimeve komplekse e voluminoze dhe krijimin e grupeve hetimore për çështje penale konkrete, lidhur me veprat penale prioritare të rekomanduara, duke caktuar kryetar të grupit hetimor një prokuror, në funksion jo vetëm të ushtrimit me efikasitet të ndjekjes penale/pasurore, por edhe balancimit e ngarkesës;

- n) bashkërendon dhe koordinon me efikasitet veprimtarinë me prokuroritë e tjera kur kjo kërkohet në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara;
- o) bashkëpunon në mënyre efektive me institucionet shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe organizon dhe zhvillon analiza të përbashketa ndërinstitucionale sipas nevojave, jo më pak se çdo 6 (gjashtë) muaj;
- p) koordinon dhe organizon trajnime të përbashketa me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe lehtëson pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashketa me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat dhe drejtimet e rekomanduara, veçanërisht në fushën e korrupsionit, krimeve të rënda, trafikëve, krimin financiar, krimin kibernetik, krimin mjedisor, veprave me natyrë gjinore, seksuale, diskriminuese, krimin në familje dhe dhunës në familje, keqtrajtimit, shfrytëzimit e trafikimit të të miturve, me fokus në format e reja të nxitura nga zhvillimet teknologjike dhe hetimin financiar paralel për krimet që gjenerojnë të ardhura.

Neni 6

Masat procedurale të drejtuesit të seksionit

1. Drejtuesit e seksioneve, sipas kompetencave ligjore, vlerësojnë rekomandimet prioritare dhe nevojat për marrjen e masave procedurale në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale për luftën ndaj kriminalitetit në kompetencë të seksionit që drejtojnë, si dhe për të siguruar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose udhëzimeve të drejtuesit të prokurorisë që ndihmojnë dhe/ose lehtësojnë në rritjen e efikasitetit në veprimtarinë e seksionit dhe efektivitetin në luftën kundër kriminalitetit, sipas prioriteteve të rekomanduara, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve, marrin masat si me poshte:
 - a) janë aktivë dhe nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje, përfshirë rastet e regjistruara/filluara kryesisht, ose kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit dhe zbatimin e politikës penale për veprat penale prioritare të rekomanduara në kompetencë të seksionit që drejtojnë;
 - b) janë aktiv në marrjen e dëgjimit për vepra penale nga burime të hapura dhe në fillimin kryesisht të procedimeve/hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara në kompetencë të seksionit që drejtojnë;
 - c) zhvillojnë mbledhje e diskutime tematike me prokurorët e seksionit, apo me oficerët e policisë gjyqësore të seksionit apo shërbimeve të tjera të Policisë Gjyqësore, në kuadër të luftës kundër veprave penale prioritare të rekomanduara;
 - d) koordinojnë e bashkërendojnë me drejtuesin për rritjen e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara në kompetencë të seksionit që drejtojnë, si dhe për organizimin dhe zhvillimin e analizave të përbashketa ndërinstitucionale sipas nevojave;
 - e) raportojnë dhe propozojnë drejtuesit të prokurorisë marrjen e masave konkrete për raste të caktuara;
 - f) bashkëpunojnë me drejtuesin e prokurorisë për të siguruar kontrollin dhe balancimin e

ngarkesës prokurorëve dhe oficerve të policisë gjyqësore të seksionit që drejtojnë dhe propozojnë/sugjerojnë masa përkatëse për personat përgjegjës, në drejtim të luftës kundër veprave penale prioritare.

Neni 7

Masat procedurale/administrative të prokurorit

1. Prokurorët vlerësojnë në çdo rast masat në rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit në kompetencë të tyre dhe udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe/ose udhëzimet/urdhërat e drejtuesit të prokurorisë për të garantuar zbatimin e tyre, që ndihmojnë dhe/ose lehtësojnë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, sipas prioriteteve të rekomanduara, dhe duke ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim i paligjshëm në vendimarrjen e tyre, marrin masat procedurale të udhëzuara, si me poshte:

- a) janë aktiv gjatë hetimeve paraprake, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara;
- b) shtojnë përpjekjet dhe tregojnë kujdes maksimal për të garantuar pavarësinë e tyre, shmangur ndikimin e paligjshëm, raportojnë menjëherë tek drejtuesi rastet e ndërhyrjeve të paligjshme, forcojnë bashkëpunimin ndërinstitucional, sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut në proces penal, si dhe ndërtuar një ndjekje penale efektive ndaj krimit të organizuar, korrupsionit si dhe ndaj veprave penale dhe subjekteve prioritare të rekomanduara.
- c) marrjen e masave të nevojshme për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë e tyre dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, duke bashkëpunuar ngushtë me prokurorin për mardhënien me median dhe publikun, në përuthje me ligjin dhe udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm 05/2019.
- d) kryejnë hetime të plota e të gjithanshme për veprat penale dhe/ose ndaj subjekteve për veprat penale prioritare të rekomanduara, sipas kompetences lëndore, në bashkërendim me Prokurorinë e Posaçme sipas ligjit dhe aktit të koordinimit ndërinstitucional, duke rritur më tej treguesit/rastet e hetimeve proaktive efektive, përdorimin e metodave speciale të hetimit sipas ligjit, dhe hetimet financiare ose procedimet pasurore (*ndiq paranë*), si mjete për kërkimin e provave dhe për sekuestrimin/konfiskimin e pasurive/aseteve produkte të veprave penale ose veprimtarive kriminale prioritare të rekomanduara;
- e) vlerësojnë dhe konsiderojnë më tepër ekzistencën e kushteve/kritereve ligjore për lidhjen e marrevëshjeve të bashkëpunimit në zbatim të nenit 37/a të Kodit të Procedurave Penale, duke synuar vënien përpara përgjegjësisë të çdo bashkëpunëtorit në veprimtarinë kriminale, për të parandaluar dhe riparuar dëmet e shkaktuara për veprat penale prioritare të rekomanduara;
- f) rritin përdorimin me efikasitet të bazave të të dhënave të institucioneve ligjzbatuese të tjera ku prokuroria ka akses për rritjen e efektivitetit, shpejtësisë dhe fshehtësisë të hetimeve derisa i pandehuri të marrë dijeni për to, sipas ligjit;
- g) kryejnë analiza të përbashkëta me oficeret e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse dhe/ose të agjencive ligjzbatuese, për rastet e referuara, në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë e të gjithanshëm, ndaj subjekteve dhe për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke i dokumentuar takimet;

- h) tregojnë kujdes të shtuar në ruajtjen e sekretit të hetimit dhe ndalimin e publikimit të akteve, duke konsideruar veçanërisht mundësinë e përfshirjes së punonjësve shtetërorë si bashkëpunëtorë të “jashtëm ose brendshëm” në këto vepra penale.
- i) sigurojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm sipas fushave/drejtimeve prioritare të rekomanduara dhe akteve/marrëveshjeve të përbashkëta ndërinstitucionale të rekomanduara që unifikojnë dhe lehtësojnë koordinimin dhe bashkërendimin me strukturat/institucionet në fushat përkatëse të rekomanduara;
- q) kujdesen për zbatimin efektiv të të drejtave procedurale të të pandehurve/personave nën hetim apo të dyshuarve dhe sigurimin e drejtësisë miqësore për të miturin në konflikt me ligjin, si dhe garantojnë trajtimin me respekt për dinjitetin njerëzor dhe mbrojtjen nga ridëmtimi, riviktimizimi i viktimave të veprave penale gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre në proces;
- r) ndjekin një politike penale efektive dhe eficiente, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimeve prioritare të rekomanduara, ashtu dhe për parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të veprave penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar qartë dhe plotësisht në aktet/kërkesat/konkluzionet procedurale, si rrethanat e faktit të bazuara në prova, ashtu dhe kushtet/kriteret ligjore për:
- ashpërsimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurve për veprat penale në fushën e narkotikeve dhe trafikeve, krimit në familje dhe dhunës ndaj grave, kryesisht ndaj autorëve recidivistë të këtyre veprave, veprave me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimin, shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve;
 - vijimin e aplikimit të masave alternative të shmangies ndaj të miturve në konflikt me ligjin dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, kryesisht në drejtim të respektimit të garancive proceduriale;
 - sigurimin e zbatimit me kujdes të posaçëm të garancive proceduriale ndaj viktimave të mitur, për të mbrojtur efektivisht interesin më të lartë të të miturit, mirëqenien dhe jetën e tij private, parandalimin e riviktimizimit të tij;
 - aplikimin e dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autoreve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël ose personave me probleme shëndetësore, sipas rekomandimeve prioritare;
 - ndjekjen me diligenccë të shtuar dhe rritjen e numrit të procedimeve, të pandehurve të dërguar për gjykim, dhe të dënuarve për veprat penale të pastrimit të parave, veçanërisht persona të tretë profesionistë dhe/ose subjekte raportuese (gatekeeper), ashtu dhe për rritjen e hetimeve financiare e pasurore sipas ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar, për identifikimin, sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive prodhuese të veprimtarisë kriminale, ose vlerën ekuivalente, bazuar në prova/rrethana fakti objektive sipas ligjit;
 - rritjen e numrit të çështjeve të hetuara dhe dërguara për gjykim për vepra penale në fushën e mjedisit, taksa – tatimeve dhe krimit kibernetik, duke siguruar bashkëpunimin dhe ekspertizën e institucioneve referuese dhe të specializuara;
 - rritjen e numrit të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë dhe për rritjen e numrit të kërkesave në zbatimin e instituteve procedurale penale të gjykimit me marrëveshje dhe urdhrit penal, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare të rekomanduara;

➤ rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime apo në tryeza diskutimesh, si dhe trajnime të përbashketa me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet e tjera policore gjyqësore, veçanërisht në fushën e korrupsionit, krimeve të rënda, trafikeve, krimin financiar, krimin kibernetik, krimin mjedisor, veprave me natyrë gjinore, seksuale, diskriminuese, krimin në familje dhe dhunës në familje, keqtrajtimit, shfrytëzimit e trafikimit të të miturve, me fokus në format e reja të nxitura nga zhvillimet teknologjike dhe hetimin financiar paralel për krimet që gjenerojnë të ardhura;

s) raportojnë çdo një muaj me shkrim për drejtuesin e seksionit dhe për dijeni drejtuesin e prokurorisë për rezultate konkrete të arritura në zbatim të prioriteteve të udhëzuara me këtë udhëzim të përgjithshëm dhe planin e veprimet që do miratohet.

Neni 8

Marrëdhënie me policinë gjyqësore

1. Prokurori vlerëson për çdo rast zbatimin e parimit të specializimit dhe urdhëron si rregull për kryerjen e hetimeve paraprake oficerët e policisë gjyqësore të agjencisë përkatëse që ka referuar veprën penale në prokurori.

2. Në raste të veçanta, vetëm me kërkesë të arsyetuar të prokurorit për të garantuar objektivitetin e hetimit, drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit i deleguar nga ky i fundit, mund të urdhëroje për kryerjen e hetimeve oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të tjera ose të seksioneve të policisë gjyqësore në prokurorinë që drejton. Drejtuesi i Prokurorisë mund të veprojë në këtë mënyrë edhe kryesisht, mbi bazën e vlerësimit të rrethanave objektive.

3. Shtim i rasteve të urdhërua nga prokurori dhe/ose drejtuesi i prokurorisë për kryerjen e veprimeve hetimore të përbashketa prej oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve të organeve ligjzbatuese dhe seksionit në prokurori, sipas prioriteteve të rekomanduara, kryesisht për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes për vepra penale prioritare të rekomanduar.

4. Prokurorët duhet të jenë aktivë dhe ushtrojnë sistematikisht, së paku një herë në dy javë, kontroll efektiv ndaj oficerëve të policisë gjyqësore në ecurinë e hetimit të procedimeve penale në ndjekje për ligjshmërinë, objektivitetin, plotëshmërinë dhe respektimin e afateve në veprimet hetimore të kryera dhe/ose vlefshmërinë e akteve procedurale të përfutuara, në drejtimet prioritare të rekomanduara, si dhe propozojnë e inicojnë masa konkrete në rast konstatimi të shkeljeve, në përputhje me ligjin.

5. Nga drejtuesit e seksioneve dhe/ose prokurori i çështjes të tregohet diligençë e shtuar në drejtim të sjelljeve të oficerëve të policisë gjyqësore që përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit, dhe inicohet fillimi i procedimit disiplinor sipas ligjit.

KREU IV

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 9

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim dhe dispozitave ligjore/nënligjore referuese të këtij udhëzimi, mund të përbëjë shkelje disiplinore sipas ligjit dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve ndaj prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore apo personave të tjerë përgjegjës.

Neni 9

Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga drejtuesit e seksioneve, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të organeve ligjzbatuese dhe të seksionit në Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Ngarkohet drejtuesi i seksionit të posaçëm për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi dhe marrë masat e duhura për raportimin periodik, dhe në çdo rast që kërkohet nga drejtuesi i prokurorisë apo Prokuroria e Përgjithshme, të të dhënave për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Për këtë qëllim, drejtuesi i seksionit të posaçëm, mund të ngarkoje me punë dhe kërkojë të dhëna nga kryesekretare, sekretar përgjegjës për zyrën e regjistrimit, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore, etj, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Drejtuesit e seksioneve dhe prokurorët janë përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 10

Shfuqizime

Udhëzimi i Përgjithshëm i drejtuesit të Prokurorisë nr. 2/2023 *“Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”*, shfuqizohet.

Neni 11

Hyrja në fuqi

1. Ky urdhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Me kryerjen e njoftimeve dhe publikimin e udhëzimit ngarkohet koordinatore e marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

DREJTUESI I PROKURORISË

Elion MUSTAJ